

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës  
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **06.06.2024** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: "**LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)**" të kandidatit **Mr. Ridvan Xhaferi**.

Në bazë të vendimit **16-352/2** të datës **06.06.2024**, Komisioni i përbërë nga: **Prof.dr. Adnan Ismaili** (kryetar), **Prof.dr. Sulejman Baki**, **Prof.dr. Ziber Lata**, **Prof.dr. Musa Musai** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Metin Izeti** (mentor), pasi analizoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

**RAPORT**

*për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës*

**1. Të dhënat biografike për kandidatin**

Ridvan Xhaferi lindi me datë 01.01.1975, në fshatin Studeniçan të Shkupit. Shkollën fillore në fshatin e lindjes, ndërsa shkollën e mesme e kreua në Medresenë "Isa Beu", në Shkup. Studimet e para deridiplomike në Fakultetin e të Drejtës Islame në Universitetin Zerka në Mbretërinë e Jordanit. Studimet pasdiplomike në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, programi studimor: Filologji orientale, drejtimi Gjuhë dhe letërsi arabe, me temë magistrature **Përmasat semantike dhe gjuhësore në suren Inshirah**. Studimet e doktoraturës i ka filluar në vitin akademik 2021/2022, në Fakultetin Filozofik të Universitetin e Tetovës, program studimor: Shkenca mbi gjuhën, drejtimi: Filologji orientale.

## **2. Pasqyrë e aktivitetave të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës**

Kandidati Mr. Ridvan Xhaferi që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndejej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Punimet e tij gjatë kësaj periudhe janë:

- Roli i Zemahsheriut në ruajtjen e origjinalitetit të gjuhës arabe / Ridvan Xhaferi, International Journal of Albanology, (Albanologia, vol.10, No.19-20, pp 1-558, Tetova, 2023), UDC: 28-23:811.411.21'02
- Sureja Kadr sipas interpretimit të Zemahsheriut / Ridvan Xhaferi [//www.mesazhi.com/sureja-kadr-sipas-interpretimit-te-zemahsheriut/](http://www.mesazhi.com/sureja-kadr-sipas-interpretimit-te-zemahsheriut/)
- Fryma Zemahsheriane në sqarimin e ajeteve të agjërimit / Ridvan Xhaferi [https://shenja.tv/fryma-zemahsheriane-ne-sqarimin-e-ajeteve-te-agjerimit/#\\_ftn1](https://shenja.tv/fryma-zemahsheriane-ne-sqarimin-e-ajeteve-te-agjerimit/#_ftn1)

## **3. Analizë e disertacionit të doktoraturës**

Disertacioni i doktoraturës me titull: "**LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)**" i kandidatit **Mr. Ridvan Xhaferi** përbëhet nga Hyrja, pesë kapituj, , Përfundimi dhe Rekomandim si dhe Bibliografia.

Në **Hyrje**, kandidati e diskuton metodologjinë hulumtuese gjatë punimit të disertacionit duke dhënë një pasqyrë të gjerë edhe të punimeve dhe studimeve ndërkombëtare në çështjen e hermeneutikës kuranore dhe veçanërisht të tefsirit të Zemahsheriut si dhe e paraqet me saktësi rrugëtimin e tij shkencor gjatë studimit në fjalë. Përgjatë historisë, konstaton kandidati çështja që i ka preokupuar më shumë njerëzit që besojnë në një fe dhe ata që merren me mësimin e saj ka qenë të kuptuarit dhe interpretimi i teksteve fetare, të cilat, në fakt, vetë ato janë një interpretim i ekzistencës. Arsyja kryesore e kësaj ka qenë bartja e Zbulësës që vinte nga Zoti dhe e fjalëve dhe sjelljeve të Pejgamberit që ishte edhe zbatuesi praktik i Zbulësës – nga brezi në brez, qoftë në mënyrë gojore, qoftë në formë të shkruar. Çështja është e tillë sepse arsyja që vetëm fjala dhe përcjellja që përdorin njerëzit në një gjuhë ose në dialektet e stilet e saj, nuk mjaftojnë për të shprehur në mënyrë shteruese qëllimin dhe synimin e njeriut.

Përveç kësaj, edhe fakti që gjuha e fesë, për shkak të strukturës që ka, krahas shprehjeve muteshabih – “të shumëkuptimshme” kemi edhe teshbih-un – “përngjasimi”, tenzih-un – “besimi në përsosurinë hyjnore”, temthil-in – “alegorisë” dhe stilin e të folurit me simbolikë, gjë që e vështirëson akoma më shumë të kuptuarit e këtij qëllimi. Për më tepër, edhe shkalla e përfitimit nga leximi dhe dëgjimi i këtyre teksteve ndryshon sipas gjendje si ndividuale dhe shoqërore të njeriut. Po i njëjti ndryshim ndodh edhe sipas formave gjuhësore që ka fjala hyjnore dhe familjarizimi me gjuhën e fesë.

Si rrjedhojë, kandidati pohon se hulumtimi i bërë mëton ti ngërthejë qëllimet si më poshtë:

- Konceptet retorike dhe gjuhësore të Kur'anit duke u përqendruar në shembullin e tefsirit *Keshaf* të Zemahsheriut, me qëllim që të shërbejë për kuptimin më të mirë dhe më të përditësuar të tekstit sakral.
- Analizën e koncepteve dhe retorikës kur'anore: stilistika, retorika, semantika, gramatika, sintaksa, krahasimi, konteksti etj..
- Hapja e shtigjeve të reja për analizë më të hollësishme të elementeve gjuhësore, retorike, dhe stilistike për hulumtimet e ardhshme.
- Argumentimi i interpretuesit të Kur'anit me krahasim dhe vëzhgim.

Nga problemet dhe pyetjet që lindin nga hulumtimi, kandidati, i veçon:

1. Karakteristikat e epokës, jetës dhe veprave të Zemahsheriut.
2. Degët e Retorikës/Belagas të cilat i ka trajtuar Zemahsheriu.
3. Konceptet dhe formacionet gjuhësore dhe të arriturat shkencore të cilat i ka shfrytëzuar Zemahsheriu për të sqaruar dhe komentuar suren Neml.
4. Stilistika /Ilmul Bejan, Tropika / Ilmul Bedi' dhe Semantika / Ilmul Me'ani si disiplina gjuhësore të përdorura nga Zemahsheriu për komentimin e sures Neml.

Në **Kapitullin e parë**, diskutohet në hollësi jeta dhe vepra e Zemahsheriut, në veçanti duke u ndalur në qëndrimin e tij në Mekë, paraqiten mësuesit dhe nxënësit apo ndjekësit e tij si dhe analizohet veprimtaria intelektuale dhe kontributi i tij shkencor. Zemahsheri pas vetes, konstaton kandidati, ia trashëgimi të madhe veprash dhe bibliotekë të pasur në shkenca të ndryshme, të cilat emrin e tij e bënë të njohur në të gjitha provincat islame, por duke dominuar në gramatikë, gjuhë, letërsi, fjalë të urta dhe predikime. Vepra që e nxori emrin e tij në orbitën e dijetarëve të rrallë islamë, është tefsiri i mirënjohnur në qarqet shkencore: “El Kesh-shafu an hakaiki-t-tenzili ve ujuni-l ekavili fi vuxhuhi-t-te’vili” (Zbulimi i të vërtetave të zbritjes dhe burimet e mendimeve në aspektet e interpretimit).

Veçanërisht janë të rëndësishme veprat e tij në fushën e tefsirit, që njëkohësisht e paraqet edhe skeletin e këtij disertacioni. Ai shkroi dy tefsira të njojur të Kur'anit, si:

- El Kesh-shafu an Hakaiki-t-Tenzili ve Ujuni'l Ekavili fi Vuxhuhi-t-Te'vili" (Zbulimi i të vërtetave të zbritjes dhe burimet e mendimeve në aspektet e interpretimit), i cili është i vlerësuar për analizën gjuhësore dhe gramatikore të tekstit të Kur'anit.
- Risale fi't Tefsir (Mesazhe në interpretimin e Kur'anit, kjo vepër njihet gjithashtu si "Keshf fi'l Kira'at" (Zbulesa e Leximeve) dhe "Keshf fi'l Kira'at el-'Ashr" (Zbulesa e dhjetë leximeve). Ai merret me dhjetë leximet variante (el-Kira'at el-'Ashr) në vend të shtatë leximeve të pranuara dhe të njoitura gjerësisht (el-Kir'atu's Seb'). Kjo është vepra e dytë që Zemahsheri ka shkruar mbi Kur'anin, përvèç "Keshaf"-it.
- I'xhaz Sure el-Keuther (Mrekullia e sures Keuther): Siç mund të kuptohet nga titulli i librit, është një vepër në të cilën interpretohet Sureja Keuther nga këndvështrimi I'xhaz (Mbinatyrshtmërisë).

Në **Kapitullin e dytë**, në hollësi përshkruhet dhe analizohet në kuadër të shumë nëntitujve ekzegjeza kur'anore / tefsiri i tij "KESHAFI", koncepti i ekzegjezës (Tefsir) dhe Hermeneutikës (Te'vil), ekzegjeza Kur'anore (Tefsiru'l Kurani), metodat e ekzegjezës kur'anore, dorëshkrimet e Keshafit, burimet e përdorura të Zemahsheriut në Keshaf, metodologjia e ekzegjezës në Keshafin e Zemahsheriut, ajetet e qarta (Muhkemat) dhe ajete shumëkuptimshme (Mutashabihat), "EL-FANKULA" Pjetje dhe Përgjigje Stilistike (es'ilá ve-exhvibe), interpretimi i Kur'anit me Kur'an (Tafsiru'l Kur'an bi'l Kur'an), interpretimi i Kur'anit me Hadith (Tafsiru'l Kur'an bi'l Hadith), leximet variante të Kur'anit (Kira'at), shkaqet e zbritjes të Sureve (Esbabu'n Nuzul), lajmet Hebreje (Israilijatet), shfuqizimi në Kur'an (Nasih dhe Mensuh), karakteristikat dhe Virtytet e Sures. Zemahshariu pavarësisht nga fakti se në tefsirin tij ndjek tekstin e Kur'anit nga fillimi deri në fund, teknikat e tij ekzegjetike ndryshojnë nga formati standard i ekzegjezës tradicionale. Karakteristikat kryesore të tefsirit të tij janë: theksimi i vargjeve të qarta dhe shumëkuptimshme "Muhkem dhe Muteshabih", rëndësia e semantikës dhe stilistikës "Ilm el-Me'ani dhe Ilm el-Bejan", formati i pyetjeve dhe përgjigjeve "Es'ile ve-Exhvibe", "Interpretimi i Kur'anit me anë të Kur'anit" (Tefsir al-Kur'an bi-al-Kur'an), interpretimi i Kur'anit me hadith, leximet variante të Kur'anit (Kira'at), etj. Këta komponentë të ekzegjezës janë zbatuar në mënyrë unike prej tij në të gjithë Keshafin, gjë që ilustrohet në këtë kapitull.

Në **Kapitullin e tretë**, që njëkohësisht e paraqet edhe zbardhjen e idesë gjeneruese dhe themeltare të punimit diskutohen çështjet e ligjërimit dhe aspektet retorike në tefsirin "Keshaf", ligjërimi (HITAB), ligjërimi Kur'anor (Hitabu'l Kur'ani), ndikimi i ligjërimit kur'anor në letërsinë shqipe, mendimet e orientalistëve mbi ligjërimin kur'anor, karakteristikat e gjuhës kur'anore, ndikimi i Kur'anit në gjuhën arabe, Zemahsheri dhe polemikat mbi përkthimin e Kur'anit, mbinatyryshmëria ose Mrekullia e Kur'anit (I'xhazu'l Kur'an), vargëzimi (en-Nadhm), konteksti (Es-Sijak), pragmatika (et-Tedavulije), aspekti dhe prirja letrare e Zemahsheriut në Keshaf, portretizimi (et-Tem'thil), retorika (belaga), stilistika (Ilmu'l Bejan), tropika (Ilmu'l Bedi'), semantika (Ilmu'l Me'an). Kurani i shenjtë është unik, jo vetëm sa i përket kuptimit, mendimit dhe mesazhit të tij, por edhe në lidhje me formën, intonacionin dhe diksionin e tij. Ai i'u shpall Muhamedit (a.s) më shumë se 1400 vjet më parë dhe është pa dyshim një kryevepër e letërsisë. Forca dhe bukuria e pakrahasueshme e gjuhës, ritmit dhe intonacionit kanë frysmezuar dijetarët myslimanë, po ashtu dhe ata jomyslimanë. Dijetari francez Paul Casanova flet për gjuhën e mrekullueshme të Kur'anit me këto fjalë: "Saherë që Muhamedit i kërkohej një mrekulli, si provë e vërtetësisë së misionit të tij, ai përmendte përbërjen e Kur'anit dhe përsosmérinë e tij të pakrahasueshme, si prova të origjinës së tij hyjnore. Faktikisht dhe për ata që nuk janë myslimanë, nuk ka asgjë më të mrekullueshme sesa gjuha e tij, e cila me një tërësi të kuptueshme dhe një tingullsi mbërthyese, i mahnitit ato popuj primitivë shumë të dhënë pas gojëtarisë. Shumica e rrokjeve të tij me intonacion madhështor dhe ritëm të mrekullueshëm kanë pasur shumë rëndësi në konvertimin e njeriut më armiqësor dhe më skeptik". Duke pasur parasysh stilin dhe strukturën e Kur'anit dr. Fadl al-Rahman Ensari, teolog i shquar, shprehet: "Çështja mund të shikohet në tre dimensione (1) tek intonacioni (2) diksioni (3) mendimi, dhe Kur'ani është i pamitueshëm dhe unik për secilën prej tyre". Ai vazhdon: "Intensiteti i Kur'anit në dimensionin e kuptimit dhe lartësia e tij për sa i përket madhështisë së tij, janë thjesht të pamatshme nga aftësia njerëzore. Dijetari amerikan Harry Gaylord Dorman e konsideron stilin e Kuranit si një mrekulli: "Ai (Kur'ani) është një shpallje falë për fjalë nga Zot, që iu diktua Muhamedit nga Xhibrili dhe është i përsosur në çdo shkronjë. Ai është një mrekulli e përhershme, që është dëshmitar për veten e tij dhe për Pejgamberin Muhamed. Cilësia e tij e mrekullueshme gjendet pjesërisht në stilin e tij, që është kaq i përsosur dhe i lartë, saqë as njerëzit dhe as xhindet nuk mund të krijojnë qoftë dhe një kapitull të vetëm që të krahasohet me kapitullin e tij më të shkurtër, dhe pjesërisht në përbajtjen e mësimave, profecive për të ardhmen dhe tek të dhënat e tij të sakta, që Muhamedi, i cili nuk dinte shkrim e këndim, nuk mund t'i mblidhte asnjëherë vetë", në mes tjerash konstaton kandidati.

Në **Kapitullin e katërt** kandidati metodologjinë ekzegjeze dhe hermeneutike të Zemahsherit e analizon në kuadër të sures Neml që parqet edhe shembullin konkret të këtij punimi. Ai në hollësi shkruan për emërtimin, vlerat dhe aspektet retorike, në suren "neml" sipas keshaf-it të zemahsherit, suren neml dhe emërtimin e saj, vlerën e sures, shkronjat e shkëputura (huruf el-mukatta'a), shkakun e zbritjes së sures, lajmet hebreje (israilijatet) në suren neml, simetria dhe uniteti tematik i sures, harmonia e sureve, para dhe pas sures neml, përdorimi i metodës "el-fankula" / pyetje dhe përgjigje stilistike, aspektet retorike në suren neml, elementet e stilistikës (ilmu'l bejan) në suren neml, përngjasimi (tesbih), metafora (isti'are), metonimia (kinaje), tropika ose tropet (ilmul bedi'), antiteza (tibak), zeugma (mushakele), kontrasti (mukabele), paranomazia ose përshtatja (xhinas), rima (sexh'), digresioni (istitrad), pragmatika (tedavulije), elementet e semantikës (ilmul me'ani) në suren neml, pauza ose separacionet kur'anor (fasile kur'anije), figura e shkëmbimit ose enallazh (el-iltifat), përsëritja e shprehjeve dhe kuptimeve (tekrar), mënyra mahnitëse (uslub et-teaxhub), mënyra pyetëse (uslub el-istif'ham), pasthirma ose thrrorja (en-nida).

Në **Kapitullin e pestë** kandidati shkruan për ndikimin e tefsirit keshaf në historine e mendimit islam, Zemahsheriu dhe opinionet e dijetarëve për tefsirin "keshaf", Zemahsheriu dhe ndikimi i tij në pesë parimet doktrinore mu'tezilite (fragmente nga keshafi), ndikimi retorik dhe letrar i zemasherit në opinionin modern musliman, komentime, shpjegime dhe shënimë që janë bërë mbi keshafin, ndikimi i Zemasherit në mendimin dhe veprat shqiptare, Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij "Ajka e kuptimeve të kur'ani kerimit" të ndikuar nga Zemahsheriu, Hafiz Ali Korça dhe veprat e tij të ndikuara nga Zemahsheriu.

Në **Përfundim**, kandidati paraqet konkluzat e punimit si dhe hap një dritatë paradigmatike me rekomandime për punimet e ardhshme në këtë fushë. Çështja e retorikës kur'anore është një ndër problemet më thelbësore në konceptimin dhe në perceptimin e Kur'anit, prandaj edhe puna në hulumtimet dhe studimet kur'anore nuk ka përfunduar dhe nuk do të përfundojë deri në ditët e fundit të kësaj bote.

Si përfundime të disertacionit paraqiten:

- Roli i Zemahsherit në ruajtjen e autenticitetit të gjuhës arabe përmes tefsirit të tij "Keshaf".
- Zemahsheriu është një interpretues dhe shkencëtar i logjikës u përpoq të tregonte për bukurinë e Kur'anit përmes perspektivave shkencore, gjuhësore, stilistikë dhe retorike.

- Në drejtim të çështjeve retorike, gramatikore dhe gjuhësore ai ka zhvilluar një dialektikë të veçantë, e cila ka shërbyer si shembull për gjeneratat deri në ditët e sodit.
- Shkenca bazike të cilës iu referua Zemahsheriu në interpretimin e Kur'anit Fisnik ishte shkenca e retorikës, sepse është e lidhur ngushtë me mrekullinë dhe elokuencën e Kur'anit Fisnik. Zoti i sfidoi arabët, por edhe gjithë njerëzimin, edhe pse njojja e tyre ishte e thellë ne gjuhën arabe dhe retorikë, ata u sfiduan për të thurur të paktën një sure, ata nuk mundën dhe kjo sfidë ende vazhdon, pavarësisht nga kalimi i shumë shekujve.
- Ai analizon dimension të integruar të metaforës së Kur'anit dhe interpretimit në tefsirin e tij Keshaf dhe ne u përpoqëm që metodologjinë dhe mënyrën e konkluzës së tij ta paraqesim në suren Neml.
- Tefsiri i tij "Keshaf" konsiderohet si një enciklopedi e retorikës arabe, bashkon lidhjen mes arabizmit dhe islamit, dhe midis gjuhës arabe dhe kulturës islame.

Lirisht mund të konkludojmë se Zemahsheriu konstaton se besimi inteligjent e inkadron domosdoshmërisht hermeneutikën e demistifikimit. Feja është hapësira simbolike, ku funksioni i rishikimit e lind funksionin e lëndës, duke i rrënuar idhujt, imazhet religioze, ngjashëm siç iluzioni i metafizikës i lind termat e qenies supreme, substancës së parë, mendimit absolut. Kjo, në një mënyrë, është ringjallja e rishikimit si send, do të thotë rënie e shenjës në çështje të jashtëzakonshme dhe mbikulturore. Edhe vetë mëkatit i idhujtarisë është në konceptin që sendet të adhurohen në vend të Zotit, pra të adhurohen reflektimet në vend të përbajtjes së tyre. Përgjithësisht, feja dhe besimi, nëse do ta kishim diskutuar në prizmin e hermeneutikës inteligjente, do të thotë pranimi i Personit Absolut, koncepteve të caktuara, rregullave dhe dispozitave, të cilat i mundëson hapësira e së shenjtës në rrugëtimin drejt Zotit; besimi në angazhimin e Zotit për njeriun dhe, që është më e rëndësishme, bindjen e plotë në mbështetjen hyjnore. Edhe fjala iman në terminologjinë islame e ka kuptimin e besimit në Zotin, por edhe të bindjes se Zoti është "me ne". Koncepti i fesë dhe besimit, në këtë rast, duhet të ndërlidhet me vetëkuptimin para tekstit të Kur'anit. Nga kjo pozitë, feja mund të përkufizohet si "brengë më e lartë", pra pranim i çështjes së vetme të domosdoshme, nga e cila orientohem dhe i zgjedh përparësitë e mia. Por "brengë më e lartë" do të ngelë memece nëse nuk e inkadrojmë fuqinë e fjalës, rrjedhimisht interpretimin e shenjave dhe simboleve, të cilat e kanë edukuar dhe trajtësuar këtë brengë gjatë shekujve. Rekomandimi kryesor i këtij studimi do të ishte se varësia metafizike absolute do të jetë e dobët dhe e pasprehur si ndjenjë, nëse nuk ekziston përgjigja për propozimin e "krijimit të ri", i cili i hap mundësitë e reja të të qenit dhe veprimit. Besimi i pakushtëzuar do të ishte i zbrazur nëse nuk bazohet në një interpretim të ri të ngjarjeve dhe simboleve për të cilat flet Kur'ani. Pra, këto

parime të zbuluesës janë ngjarje të çlirimt dhe përfshirjes së unit të thellë dhe me këtë e afrojnë veten me Krijuesin. Ky është relaciuni i përbashkët midis tekstit të zbuluesës dhe përvetësimit të tij nga njeriu dhe besimtari. Hermeneutika ka rëndësi të veçantë edhe në vetëkuptimin e vetes përballë tekstit të zbuluesës. Duhet ta kemi parasysh se ka dallim të madh midis kritikës së fesë dhe vetëkuptimit, pra pushimit, ngushëllimit në kraharorin e gjërë të fjalës hyjnore. Kjo hermeneutikë e mundëson dekonstruktimin e paragjykimeve që ia pamundësojnë tekstit hyjnor të bëhet bota vetë. Ky lloj i të qenit është një dashuri ndaj botës dhe gjithësisë, një dashuri që njëkohësisht është edhe ngushëllim edhe shpërblim.

Në pjesën e **Bibliografisë** janë rradhitur në bazë të rendit alfabetik të gjitha burimet dhe literatura e konsultuar nga ana e kandidatit.

#### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura**

Gjatë hartimit të punimit të doktoraturës me titull "**LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)**", kandidati është mbështetur dhe ka respektuar teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si, përshkrimi, analiza, krahasimi dhe kriticizmi. Për shkak të natyrës së punimit, ndarja është bërë sipas tematikës, çdo nëntemë është e lidhur me njëra-tjetrën.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar kryesisht burimet autoriale të autorit, vepra shkencore të botuara, monografi, zëra enciklopedikë, punime shkencore nga revista të ndryshme, literaturë të përgjithshme kryesisht në gjuhën arabe, turke, boshnjake, angleze dhe në gjuhën shqipe.

Përshkrimet, analizat, krahasimet dhe kritikat janë bërë në bazë të metodologjisë së mirëfilltë shkencore dhe si rrjedhojë mund të shërbejnë si një dokument dhe provë e veçantë në punimet e mëtutjeshme për temën në fjalë.

#### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit**

Rezultatet kryesore të disertacionit të doktoraturës me titull: "**LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)**", mund të rezimohen si më poshtë:

Si çdo tekst tjetër sakral, Kur'ani nuk duhet krahasuar me çfarëdolloj forme shkrimi njerëzor, pikërisht pse është mesazh hyjnor në gjuhë njerëzore. Kryesisht nuk është jokoherent teksti

sakral por njeriu, të cilil i duhet mund i madh për t'u integruar në Qendrën e tij, që mesazhi i librit Hyjnor t'i bëhet i qartë dhe t'ia zbulojë kuptimin e brendshëm.

Tërë vështirësia në të lexuarit e Kur'anit dhe në përpjekjen e arritjes së kuptimit të tij qëndrojnë të pabashkët tek matshmëria midis mesazhit Hyjnor dhe marrësit njerëzor, midis asaj që flet Zoti dhe asaj që mund të dëgjojë njeriu në një gjuhë, e cila me gjithëse sakrale mbetet gjithsesi njerëzore. Por ajo është gjuhë sakrale, sepse Zoti e ka zgjedhur si instrument komunikimi e Ai zgjedh gjithmonë të "flasë" në një gjuhë të kryehershme, e cila i shpreh të vërtetat më të thella me termat më konkretë. Vetëm paskësaj, gjuha sakrale zhvillon përmasë abstrakte e filozofike. Një gjuhë sakrale është depërtuese në thellësi dhe zakonisht pak e zhviluar në sipërfaqe, siç mund të shihet në arabishten kur'anore. Çdo fjalë mbart një botë kuptimesh dhe nuk ekziston kurrë shpjegim plotësish "horizontal" e didaktik i përbajtjes së saj. Prapëseprapë, Kur'ani përmban brenda vetes lloje të ndryshme suresh e ajetesh, disa prej të cilave janë didaktike e shpjeguese, paçka se jo në një kuptim shterues, ndërsa të tjera poetike, zakonisht të shkurtra e në shenjë. Kur'ani përbëhet nga një harlisje dhe gërshetim i jetës bimore të pyllit, të kombinuar rëndom me gjeometrinë, simetrinë dhe qartësinë e mbretërisë minerale apo një kristal të mbajtur në dritë. Ç'është e vërteta, çelësi i artit islam është ky kombinim i trajtave bimore dhe minerale, të frymëzuara nga forma e shprehjes së Kur'anit, që e shpalos këtë tipar më së qarti. Disa vargje e krerë zgjaten si arabeska, që formalizohen më vonë në botën trupore si dekorim xhamishë, kombinuar me vetë ajetet kur'anore. Të tjerë janë shpërthime të papritura të një ideje fort të qartë e të mprehtë, të shprehur në gjuhë shumë më gjeometrike e simetrike, siç shihet veçanërisht në suret përbyllëse të Kur'anit.

Tani, fuqia e Kur'anit nuk qëndron në atë se ai shpreh një fakt apo dukuri historike, por në atë se është simbol, kuptimi i të cilil mbetet gjithnjë i vlefshëm, sepse nuk ka të bëjë me një fakt të veçantë në një kohë të caktuar, por me të vërteta, të cilat, duke qenë në vetë natyrën e gjërave, janë të përhershme. Sigurisht, Kur'ani përmend fakte të caktuara si rebelimi i një populli të caktuar kundër Zotit dhe dënimisë i Tij mbi ta, siç shihet edhe në Dhiatën e Vjetër. Mirëpo edhe këto "fakte" e ruajnë fuqinë e tyre, sepse na interesojnë si simbole të një realiteti të gjithpranishëm.

Mrekullia e Kur'anit qëndron në zotërimin prej tij të një gjuhe, që e zotëron efikasitetin e prekjes së shpirtrave të njerëzve tani, katërmëdhjetë shekuj pas shpalljes së tij, po aq sa edhe në fillim të shfaqjes së tij mbi tokë. Një musliman preket nga vetë tingulli i Kur'anit, ku thuhet se provë e besimit (iman) të dikujt është të prekurit ose jo nga ezani dhe nga këndimi i Kur'anit. Kjo fuqi qëndron pikërisht te natyra e tij si simbol, jo si fakt, i një të vërtete që lidhet në mënyrë jetike me njeriun këtu e tani.

Ligjërimi gjuhësor në Tefsirin "Keshaf" të Zemahsherit është një përpjekje për të kontribuar në shpjegimin e gjuhës dhe retorikës kur'anore. S'do mend se është vështirë që si rob të Allahut të përkufizojmë fjalën e Krijuesit të Gjithdijshëm dhe të Urtë, mirëpo nëse Fjala e Allahut i është dërguar krijesave, atëherë ata duhet të përpiqen që në suazat e veta ta përkufizojnë dhe në bazë të asaj ta kuptojnë. Rruga më e mirë në përkufizimin dhe kuptimin e Fjalës Hyjnore, mendoj se është në atë që Ai vetë thotë për vehten. Në ajetet dhe emërtimet që i bëhen në tekstin e Kur'anit janë të përfaqësuara një numër i madh i karakteristikave reale të Fjalës Hyjnore të cilat njëkohësisht mundësojnë edhe qasjen më të mirë njerëzore në kontaktin me Kur'anin.

Kur'ani për Kur'anin në disa ajete thotë:

*"Rahmani- Mëshiruesi. Ai ia mësoi Kur'anin. E krijoi njeriun. Ia mësoi atij të folurit". "Ne të zbritëm ty librin me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzveme atë që të mësoi Allahu...". "Ne të shpallëm Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarë, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshprim". "...Ne ty ta shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët".*

Qasjet ndaj Kur'anit nga ana e popujve të ndryshëm kanë qenë të fushave të llojullojshme dhe si pasojë e tyre është krijuar një literaturë e bujshme në lidhje me Kur'anin. Një nga fushat të cilat më së tepërm janë marrë me ajetet e Kur'anit dhe në veçanti me brendinë dhe përbërjen shumëpërmasore të ajeteve të Kur'anit është retorika, si një nga degët e sofistikuara të gjuhësisë. Shkrimet retorike në lidhje me Kur'anin ka shumë në literaturën klasike islame, një nga bartësit kryesor të kësaj qasjeje ndaj ajeteve të Kur'anit është studjuesi i njohur Zemahsheriu. Nisur nga kjo përvojë është bërë një përpjekje modeste për t'i u qasur tefsirit të tij dhe një sureje të Kur'anit me domethënien shumë të thellë gjuhësore dhe retorike.

Gjatë këtij studimi mbi semantikën dhe aspektet gjuhësore në tefsirin Keshaf, duke veçuar si shembull suren Neml, janë diskutuar burimet klasike dhe bashkëkohore dhe sigurisht veprën e njohur mbi të cilën e kemi bazuar studimin tonë, Tefsirin "Keshaf". Gjatë studimit janë zgjedhur temat më të rëndësishme gjuhësore dhe retorike, më të lexuara e më të pranuara, si dhe komentimet e specializuara që ofrojn informacion të rëndësishëm e të disponueshëm për temën në fjalë.

Studimi mëton ti ngërthejë qëllimet si më poshtë:

- Konceptet simbolike dhe gjuhësore sipas Tefsirit Keshaf të Zemahsherit.
- Analizë e koncepteve dhe retorikës kur'anore: retorika, stilistika, semantika, tropika, gramatika, sintaksa, krahasimi, konteksti etj..

- Hapja e shtigjeve të reja për analizë më të hollësishme të elementeve gjuhësore, retorike dhe stilistike për hulumtimet e ardhshme.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit**

Disa nga nëntitujt e këtij disertacioni mund të jenë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rendësia e këtij disertacioni është përbledhja dhe analiza e tërësishme e metodologjisë hermeneutike të Zemahsheriut dhe zgjatja e ndikimit të tij në mendimin islam të përgjithshëm dhe veçanërisht në atë shqiptarë. Si rrjedhojë, prej ku edhe mund të del një pasqyrë e qartë për ndikimet dhe mënyrën e mendimit dhe veprimit të ndjekësve të tij në mesin e mendimtarëve muslimanë dhe atyre shqiptarë.

Përmes shfrytëzimit të veprave autoriale, veprave origjinale të shkruara në lidhje me mendimin e Zemahsheriut, shfrytëzimit revistave dhe literaturës relevante, punimeve dhe monografive në gjuhë të ndryshme, kandidati ka sjellë prurje të reja shkencore, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar në fushën e mendimit islam dhe filologjisë dhe me theks të veçantë për ekzegjezin dhe hermeneutikën kuratore.

Si përfundim, vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut të rendësishëm në pasqyrimin e pasurisë intelektuale dhe kulturore në përgjithësi në historinë e mendimit islam si dhe në antropologjinë kulturore të muslimanëve në përgjithësi, por edhe autorëve shqiptarë në veçabti.

### **Hulumtime të mundshme të ardhshme**

Disertacioni i doktoraturës ***"LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)"***, është temë specifike dhe brënda saj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme.

Kandidati është munduar që për të gjitha idetë dhe mendimet e Zemahsheriut të jep sqarime plotësuese të cilat mund shërbejnë për njohuri të reja jo vetëm në fushën e ekzegjezës kuratore, gjuhës arabe dhe kulturës së mendimit islam.


Vlerësojmë se punimet e këtilla janë me interes për zbardhjen e ideve dhe mendimeve origjinale të klasikëve që janë të pakta dhe si rrjedhojë pak të njohura në nënqiellin shqiptarë dhe mund të shërbejnë për zgjerimin dhe thellimin e studimeve të ardhshme. Veçanërisht përfundimi dhe rekomandimet e kandidatit paraqesin një shtytës efektiv për kahjen e zhvillimit të studimeve në të ardhmen.

### **Vlerësim dhe rekondit**

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturës "**LIGJËRIMI DHE ASPEKTET RETORIKE TË INTERPRETUARA NGA ZEMASHSERIU NË TEFSIRIN "KESHAF" (SHEMBULLI I SURES NEML)**", të kandidatit Mr. Ridvan Xhaferi, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

### **Komisioni recenzues:**

1. Prof. Dr. Adnan Ismaili (Kryetar) 

2. Prof. Dr. Sulejman Baki (anëtar) 

3. Prof. Dr. Ziber Lata (anëtar) 

4. Prof. Dr. Musa Musai (anëtar) 

5. Prof. Dr. Metin Izeti (Mentor) 

Tetovë, 24.06.2024